

REZOLUTË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, vullnetin e dyanshëm për zhvillimin e tyre të mëtejshëm në të mirë të dy vendeve dhe popujve tanë, si dhe të paqes, sigurisë dhe bashkëpunimit në rajon, e të integritetit europian dhe euroatlantik;

Duke mbajtur parasysh se Greqia, si vend mik, anëtar i Bashkimit Europian dhe NATO-s, përbën një partner shumë të rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë për arritjen e objektivit madhor për integrimin në strukturat euro-atlantike;

Duke konsideruar Konventën Europiane, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, të njohura nga të dyja palët;

Mbështetur në frymën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së mirë dhe Sigurisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

- *Vlerëson* se është koha që çështja e të drejtave të shtetasve shqiptarë me origjinë çame të rimerret në shqyrtim nga të dy palët, në frymën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së mirë dhe Sigurisë, të nënshkruar dhe të ratifikuar nga të dyja vendet;

- *I kërkon qeverisë së Republikës së Shqipërisë* të shtojë më tej përpjekjet për zgjidhjen e çështjes së pronave dhe pasurive të tjera të patjetërsueshme të popullsisë çame, në përputhje me dokumentet e njohura ndërkombëtare;

- *Çmon* se gjetja e një zgjidhjeje të shpejtë në aspektin teknik dhe juridik midis qeverive të dy vendeve për çështjen e sekuestros konservative të vendosur si rrjedhojë e Ligjit të Luftës të vitit 1940 mbi pasuritë e popullsisë çame, si dhe ngrirjen e ligjit nr. 2664 të 3 dhjetorit 1998, do të përbënin një kontribut shumë të rëndësishëm për kapërcimin e problemeve të krijuara prej tyre;

- *I kërkon qeverisë shqiptare* që nëpërmjet grupeve të posaçme të punës të bashkëpunojë me palën greke dhe, në frymën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Fqinjësisë së mirë, të përshpejtojë fillimin e negociatave me qeverinë greke për zgjidhjen e këtij problemi;

- *Shpreh* bindjen se Parlamenti i Republikës së Greqisë, i cili ushqen të njëjtin vullnet për çuarjen përpara të marrëdhënieve dypalëshe shqiptaro-greke, do të japë kontributin e tij për trajtimin me frymë konstruktive dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes së lartpërmendur, duke bërë edhe rregullimet ligjore përkatëse;

- *Ngarkon qeverinë e Republikës së Shqipërisë* që këtë Rezolutë t'ua bëjë të njohur qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare që mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemit.

Tiranë, më 8 prill 2004